



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1105/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Dragash paraqitur kundër Këshillave të vendotimeve në komunën e Dragashit, për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit që ka të bëjë parregullsi dhe mungesa të votave, për Rundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 19.11.2017, për Kryetar të Komunës në Dragash, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 22.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Dragash me shenjën ZL.Anr. 1105/2017 të datës 20.11.2017, me të cilat ka kërkuar që të rinumërohen të gjitha fletëvotimet në këto vendotime në komunën e Dragashit:

0523A/01R	0511A/01R	0502A/01R	0503A/05R	0527A/01D
0523A/02D	0511A/02D	0502A/02R	0503A/06D	0525A/01D
0512A/01D	0515A/01D	0502A/03D	0505A/01R	0531A/01R
0507A/01R	0513A/01R	0503A/01R	0505A/02D	0531A/02D
0507A/02R	0513A/02D	0503A/02R	0504A/01R	0533A/01D
0507A/03R	0508A/01R	0503A/03R	0504A/02D	0520A/01D
0507A/04D	0508A/02D	0503A/04R	0526A/01D	0526A/01D

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidatëve për kryetar të komunës së Dragashit si në pjesën e I (pare) të dispozitivit të këtij vendimi.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve nga Vendvotimet si në pikën - I- të këtij dispozitivi, duhet të përfshihen me rastin e shpalljes në rezultatin përfundimtar.

## Ar sy e t i m

Më datën 20.11.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë me numër ZL Anr. 1105/2017, të parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Dragash, me të cilën kërkon që të rinumërohen kutit e votimit të zgjedhjeve komunale për kryetar të komunës së Dragashit për raundin e dytë, me pretendimin se numri i nënshkrimeve në listën përfundimtare të votimeve është i ndryshëm në krahasim me numrin e votuesve dhe dyshimeve për parregullsi tjera. Parashtruesi i ankesës thekson se në disa qendra numri i nënshkrimeve në LPV është dukshëm më i vogël se numri i votave të përgjithshme që jep me nënkuptuar mundësit e gabimeve që kanë ndikuar në rezultat.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe vlerësimit të provave të bashkëngjitura në ankesë në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli gjatë vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë si dhe provave të bashkëngjitura gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, duke pas parasysh numrin e madhe të parregullsive dhe veçanërisht rezultatin e ngushtë në mes të dy kandidatëve dhe mospërputhjeve të numrit të nënshkrimeve në listën përfundimtare të votuesve me numrin e votuesve dhe dyshimeve për parregullsi tjera. PZAP-i, vlerëson se këto të dhëna me parregullsitë e theksuara më lart, do të kenë ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, andaj me qëllim të eliminimit të çdo dyshimi dhe për të ruajtur besimin dhe transparencën në procesin zgjedhor PZAP-i, urdhëron KQZ-në, që në të gjitha vendvotimet e cekura në pjesën e I të dispozitivit të këtij vendimi, të rinumëron fletvotimet të cilat kanë qenë në kutin e votimit në të gjitha vendvotimet e lartcekura në Komunën e Dragashit.

Vendimi i PZAP-it ka mbështetje të nenit 106 par.2 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë”*

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga rinumerimet e bëra si në pjesën e I të dispozitivit, të këtij vendimi, duhet të përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1105/2017 me datën 22.11.2017.



**Kryesues i Panelit  
Hasan Shala**

***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi Gjykatës Supreme të Kosovës.*